

Llogaritja e vlerës së mineralit të bakrit të përdorur për prodhim koncentrat

Renta Minerare është produkti i vlerës së mineralit me përqindjen e rentës.

Pra duhet të llogarisim fillimisht vlerën e tregut për mineralin të bakrit.

Për rastin kur minerali shitet direkt, **Renta Minerare llogaritet si produkt i vlerës së faturës së shitjes me përqindjen e rentës.**

Për rastin kur minerali është përdorur për prodhim koncentrat bakri dhe produkt për treg do të jete koncentrat i bakrit, Vlera e Mineralit gjendet indirekt, duke llogaritur fillimisht shpenzimet e përpunimit të mineralit deri në koncentrat, duke filluar nga gryka e galerisë e deri në anijen me të cilën do të transportohet. Këto shpenzime i zbrisim nga fatura e shitjes së koncentratit të bakrit, vlera e mbetur është vlera mineralit.

Duke shumëzuar këtë vlerë me përqindjen e rentës, gjejmë vlerën e rentës që duhet paguar për koncentratin e shitur.

Për shembull:

V - shënojmë vlerën e faturës së shitjes së koncentratit të bakrit në leke (\$), të dhëna nga shitja,

S- sasisë e koncentratit të shitur në ton, e dhëna nga peshimi,

C- çmimi i shitjes së një toni koncentrat bakri në leke/ton (\$/on), e dhëna nga fatura, llogaritet me poshtë.

a- shënojmë përmbajtjen e Cu në mineralin e përdorur për prodhim koncentrat, në %, e dhëna, 0.6-2.2 %, me 0.1 % shkalla

b- përmbajta e bakrit në koncentrat, në %, e dhëna, 16.50-19.0 %, me shkallë 0.50 %.

r- shkalla e rikuperimit të Cu nga minerali në koncentrat, në %, e dhëna nga procesi 84.5 %,

p- shpenzimet e përpunimit të një toni mineral bakri për prodhim koncentrat bakri, në leke/ton (\$/t)

t- shpenzime të tjera për çdo ton mineral të përpunuar, në leke/ton (\$/t)

f- fitimi i pranuar i shoqërisë, ne % te gjithë shpenzimeve, pranohet

m- renta minerare ne %, e dhëne nga ligji

Z - vlera e mineralit ne leke (\$)

A - sasia e mineralit te përdorur për prodhimin e S ton koncentrat, ton

S- sasisë e koncentratit te shitur ne ton, e dhëne nga peshimi,

M- vlera ne total e rentës ne leke (\$).

B - shpenzimet e përpunimit te S ton koncentrat te shitur.

Në llogaritje është marre parasysh çmimi i bakrit elektrolitik “A” LME në kufij 6000 – 8000 \$/ton

Duhen llogaritur:

1. **Sasia e mineralit** te përdorur për prodhim e S ton koncentratit (sasia e dhëne ne faturën e shitjes, A, ne ton.

$$A = \frac{(100 * S * b)}{(r * a)}$$

2. **Shpenzimet e përpunimit te A ton mineral** për prodhim koncentratit, i shënojmë me B, ne leke (\$) duke filluar nga gryka e galerisë e deri na anije, ne leke (\$).

$$B = A * p * 100 / (100 - f)$$

3. **Llogaritja e çmimit te koncentratit te bakrit**

Llogaritja e çmimit te koncentratit behet mbi bazën e te dhënave te doganës (pesha e koncentratit), analizave kimike (% Cu, Au gr/t dhe Ag gr/t), çmimeve te tregut ndërkombëtar për Cu (Cu A LME) dhe çmimeve te Au dhe Ag, dhe shpenzimeve te përpunimit metalurgjik te prodhimin e Cu A LME, Au kallëp dhe Ag kallëp.

$$C = (\% \text{ Cu}-1) * \text{Çmimin e CuLME} + (\text{Au gr/t}-1) * \text{Çmimin e Au} + (\text{Ag}-30) * \text{Çmimin e Ag- shpen.perpunimit}$$

4. **Vlera e mineralit Z** ne leke (\$)

$$Z = V - B$$

5. **Vlera e rentës M** ne leke (\$)

$$M = Z * m / 100$$

Llogaritjet jane bere per:

1. Permbajtja e Au ne koncentrat bakrit eshte 3.53 gr/ton
2. Cmimi i nje onci Au eshte 1285 \$, ose 45.33 \$/gr
3. Permbajtja e Ag ne koncentrat eshte pranuar 29.0 gr/ton, per zbritje 30 njesi, nuk merret ne konsiderate.
4. Cmimi i bakrit "A" LME eshte marre 6000-10000 \$/ton